



RAPORT I RAN

Luftëtarët e huaj të kthyer dhe sfida e riintegrimin

Hyrje

Që prej fillimit të vitit 2016, numri i individëve që kishin udhëtuar drejt konflikteve në Irak dhe Siri për të rrokur armët me grupe terroriste të ndryshme islamike dhe terroriste si “luftëtarë të huaj” ishte rritur në mbi 42 000.ⁱ Një pjesë e konsiderueshme e këtyre individëve vinin nga Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), me një raport të publikuar në prill 2016 që sugjeronte se numri mund të ishte deri në 4294.ⁱⁱ Kjo shifër mund të jetë edhe më e lartë. Nga fillimi i vitit 2016, pothuajse një e treta duket se ishte kthyer në shtetet e tyre të origjinës.ⁱⁱⁱ Tani që i ashtuquajturit “Shteti Islamik” (ISIS) po pëson disfata të rënda ushtarake,^{iv} fluksi dalës i luftëtarëve të huaj duket se është ulur shumë.^v Tani në BE është kthyer një numër i paprecedent luftëtarësh të huaj terroristë dhe me rënien ushtarake të ISIS-it shumë të tjerë mund të ndjekin gjurmët e tyre. ISIS-i do të vazhdojë të inkurajojë ata brenda BE-së (qofshin të kthyer ose mbështetës) të kryejnë sulme nga vendi ku janë. Ky Raport ofron një përmbledhje të sfidave dhe mundësive për përdorimin e përjasjeve të riintegrimin për të trajtuar kërcënimin e mundshëm të sigurisë që paraqesin luftëtarët e huaj të kthyer.¹

Ky Raport është përgatitur nga Bart Schuurman dhe Liesbeth van der Heide.

¹ Veçanërisht ata që janë bashkuar me grupe xhihadiste ekstremiste si ISIS dhe Jabhat al-Nusra.



Që personat të përfshihen në terrorizëm, ata duhet të kapërcejnë barrierat e brendshme morale duke vrarë të tjerë^{vii} si edhe duke fituar një nivel bazë aftësie në përdorimin e armëve të zjarrit dhe eksplozivëve. Natyra amatore e disa prej kompleteve “të lindura brenda vendit” që kanë ndodhur në BE që prej 11 shtatorit, vërtetojnë në veçanti vështirësitë në fitimin e aftësive operacionale duke u mbështetur shpesh në manualët e shkarkuara nga interneti.^{viii} Luftëtarët e huaj të kthyer janë një shqetësim i madh sigurie pikërisht për përvojën e tyre në beteja, trajnimin në përdorimin e armëve të zjarrit dhe lidhjet me rrjetet ndërkombëtare terroriste. Humbja e ndjeshmërisë ndaj përdorimit të dhunës, kombinuar me çrregullimin e stresit post-traumatik (PTSD) që shpesh shoqëron përvojat e luftimit dhe përfshirjen e mundshme në mizori si ato që publikon me krenari ISIS-i, rrit më tej kërcënimin e mundshëm që paraqitet nga të kthyerit.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që të theksohet që luftëtarët e huaj të kthyer nuk janë një grup homogjen në lidhje me dëshirën e mundshme për të kryer akte të dhunës terroriste në shtetet e tyre të origjinës. Padyshim, ka një rrezik të madh që disa luftëtarë të huaj të kërkojnë të kryejnë sulme terroriste pas kthimit në shtëpi. Megjithatë, siç argumentoi së fundi Omar Ramadan, do të ketë gjithashtu edhe një grup të dytë individësh që mund të shihen më saktësisht si viktima të përpjekjeve të rekrutimit të ISIS-it dhe një grup i tretë të kthyerish që mund të pozicionohen diku mes viktimave dhe terroristëve (të mundshëm).^{ix} Një grup i katërt janë ata që nuk e shohin më përdorimin e dhunës si të justifikuar ose të nevojshme përmes zhgënjimit ose traumës fizike ose psikologjike të shkaktuar nga përfshirja në luftën ose jetën nën ISIS-in. Pavarësisht nëse biem dakord me përcaktime të tilla si “viktima” ose nëse vlerësojmë shpjegimet e bazuara në natyrën ose paditurinë, fakti mbetet se adresimi i problemit të luftëtarëve të huaj të kthyer duhet të marrë në konsideratë natyrën e shumëllojshme të këtij grupi individësh; si në termat e kërcënimit që mund të paraqesin dhe në rrugët më efikase për të minimizuar rrezikun e recidivizmit të lidhur me terrorizmin.

Riintegrimi i terroristëve dhe ekstremistëve sërish në shoqëri, veçanërisht kur ata janë bashkuar me grupe terroriste si ISIS-i, është një sipërmarrje kontroverze. Presioni i publikut mund të favorizojë një përjasje të llojit “burgosini të gjithë”. Përveç diskutimit mbi dëshirueshmërinë e një veprimi të tillë, procedimet ligjore në Holandë kanë treguar se sa e vështirë është të jepen dënime për krime që pretendohet se janë kryer në një shtet të huaj, veçanërisht në një shtet të përfshirë nga lufta civile.^x Shumica e individëve që janë dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin, do të lirohen në një moment në të ardhmen. Me fjalë të tjera, kërkimi i mënyrave për menaxhimin e riintegrit të (ish) terroristëve për të minimizuar mundësitë e dhunës në të ardhmen nuk bëhet për të zgjedhur një përjasje “të butë”, por duke iu përgjigjur me pragmatizëm një sfide të komplikuar.



Konteksti: deradikalizimi krahasuar me shkëputjen

Riintegrimi i (ish) terroristëve^{xi} ose ekstremistëve^{xii} mund të shihet si proces që synon mundësimin e riintegrit të tyre në shoqëri në mënyrë të tillë që redukton mundësinë që ata t'i kthehen aktivitetit terrorist. Programet specialiste që fokusohen te riintegrimi i terroristëve (“xhihadistë”) ka fituar vëmendje gjatë viteve të fundit në mbarë globin.^{xiii} Disa prej këtyre nismave fokusohen në burgosjen e terroristëve ose të ekstremistëve, të tjera theksojnë lirim me kusht pas mbajtjes nën arrest, dhe një set i tretë nismash shtrihet në të dyja këto kontekste.^{xiv} Pavarësisht nga mbizotërimi i këtyre programeve, ka një mungesë kritike njohurish nëse këto nisma aktualisht kontribuojnë ose jo për reduktimin e recidivizimit të lidhur me terrorizmin. Kjo bëhet për shkak të mungesës së studimeve të vlerësimit.

Megjithëse ka pasur vlerësime të vlefshme të programeve të riintegrit që fokusohen te islami-stët^{xv} si edhe ekstremizmi i dhunshëm i majtë ose i djathtë,^{xvi} shumica e programeve të riintegrit nuk janë vlerësuar.^{xvii} Si mund të hartohen dhe implementohen programe të suksesshme pa kuptuar nëse dhe si mund të funksionojnë ato?^{xviii} Agjencitë qeveritare që shpesh janë palët kryesore përgjegjëse për hartimin dhe implementimin e këtyre sipërmarrjeve, mund të jenë hezituese për të lejuar kontrollin e jashtëm të një subjekti delikat të lidhur me kundërterrorizmin.^{xix} Megjithatë, nëse nuk kryhen më shumë studime vlerësimi, politikëbërësit, specialistët dhe akademikët privohen nga “mësimet e nxjerra” që mund të përdoren për të hartuar dhe implementuar programe më të efektshme.^{xx}

Një mangësi e dytë e lidhur me këtë është mungesa e një kuptimi të qartë se çfarë përbën “sukses” në riintegrimin e (ish) terroristëve dhe ekstremistëve. Në vitin 2008 në Holandë, për shembull, rreth 50% e të burgosurve të rritur dhe të rinj kryen sërish krime brenda dy viteve pas lirimit nga mbajtja nën arrest.^{xxi} Nuk është e qartë nëse një normë e ngjashme recidivizmi për ata që kanë kryer vepra terroriste mund të etiketohej si sukses, për dy arsye. Së pari, duke parë ndikimin shoqëror të terrorizmit, shumë qytetarë mund të mos e perceptojnë si sukses një normë recidivizmi prej 50%, ose të paktën në përputhje me mesataren kombëtare. Së dyti, ka të dhëna të pamjaftueshme rreth rikthimit në vepra terroriste, veçanërisht në BE, duke e lënë të paqartë se sa do të ishte një normë e dëshirueshme recidivizmi për programet e riintegrit që do të synohen.^{xxii} Prandaj, megjithëse “reduktimi i recidivizmit” është shpesh objektivi i programeve të riintegrit, mungesa e të dhënave rreth këtij subjekti pengon një vlerësim objektiv të suksesit.

Mungesa e informacioneve praktike rreth asaj se çfarë funksionon kur bëhet fjalë për riintegrimin e terroristëve dhe ekstremistëve, sugjeron shqyrtimin e mekanizmave përbërës si mënyrë për të kuptuar se si funksionojnë dhe si mund të përmirësohen këto programe, aty ku është nevoja. Supozimet që ata që hartojnë dhe implementojnë programet e riintegrit kanë rreth objektivave për t'u arritur dhe se si mund të arrihen ato, janë të rëndësishme në suksesin ose dështimin e këtyre përpjekjeve.^{xxiii} Në përgjithësi, mund të dallohen dy përjasje; deradikalizimi dhe shkëputja.^{xxiv} Megjithëse paragrafët e mëposhtëm i diskutojnë këto koncepte veçmas, është e rëndësishme të vihet re se ato nuk janë përjashtuese të njëra-tjetrës; në fakt, duke qenë se ende është e paqartë se cila funksionon më mirë, një kombinim i të dyja përjasjeve ofron fleksibilitet dhe maksimizon shanset për sukses.



Radikalizmi dhe deradikalizimi janë bërë koncepte të familjes që kur ato u bënë pjesë e debatit të politikave rreth vitit 2004.^{xxv} Popullariteti i tyre zbulon mangësitë e shumta dhe serioze që përmbajnë ato.^{xxvi} Më problematik është nocioni (shpesh i nënkuptuar) se pranimi i pikëpamjeve radikale detyrimisht çon në përfshirje në sjellje radikale, dhe se në mënyrë të ngjashme distancimi nga terrorizmi sjell braktisjen e këtyre pikëpamjeve.^{xxvii} Një lidhje e tillë është thjeshtim i tepruar i një realiteti kompleks që nuk përkon me arsyet teorike dhe empirike.

Për miliona njerëz që kanë pikëpamje radikale ose ekstremiste, përbindja e atyre që përfshihen në aktivitete terroriste është jashtëzakonisht e vogël.^{xxviii}

Studimet kanë treguar gjithashtu se jo të gjithë terroristët janë të motivuar në mënyrë parësore nga bindjet e tyre.^{xxix} Një përjasje ndaj riintegritit që fokusohet vetëm te deradikalizimi, nuk merr parasysh faktin e rëndësishëm se distancimi nga grupet ekstremiste dhe terroriste parashikohet mbi një mori arsyesh që shkojnë përtej ideologjisë. Këto arsye përfshijnë zhgënjimin me efektshmërinë e dhunës, prishjen e marrëdhënieve me bashkëqytetarët dhe tërheqjet e një jete të rregullt.^{xxx} Anasjelltas, faktorë të tillë si trysnia e personave të përafërt dhe frika e hakmarrjes nga shokët e mëparshëm mund të krijojnë pengesa për ndalimin e përfshirjes në grupe ekstremiste ose terroriste.^{xxxi}

Duke parë rrugët e daljes nga ekstremizmi dhe terrorizmi vetëm përmes konceptit të dyshimtë nga ana empirike dhe teorike të deradikalizimit, rrezikohet kështu të hiqet dorë nga rrugë të ndryshme përmes të cilave mund të arrihet objektivi i reduktimit të recidivizmit. Nëse, për shembull, përfitimet sociale të pjesëmarrjes në grupe terroriste (statusi, shoqëria dhe një sens objektivi në jetë) ka sjellë përfshirjen e individëve në këtë grup, është i rëndësishëm krijimi i një mjedisi shoqëror alternativ por jo radikal që mund të ofrojë përfitime të ngjashme.^{xxxii} Sigurisht, deradikalizimi ende mbetet një mjet i rëndësishëm për ata që janë motivuar pikësëpari ideologjikisht për t'u përfshirë në terrorizëm. Ajo që nënkuptohet është se në bazë të kuptimit tonë aktual të problemeve në fjalë, ai nuk duhet të jetë mjeti i vetëm ku mbështeten programet e riintegritit.

Një theks i tepruar mbi deradikalizimin gjithashtu nuk merr parasysh shembujt e shumtë historikë të terroristëve që riintegruan në shoqëri (me sa duket) pa u deradikalizuar fillimisht.^{xxxiii} Mes viteve 1960 dhe 1990, u burgosën me mijëra terroristë evropianë që u përkisnin grupeve të tilla si IRA, ETA, Brigadave të Kuqe italiane dhe RAF në Gjermani. Shumica e tyre janë liruar nga burgu pa iu nënshtruar programeve të deradikalizimit. Fakti se shumica e këtyre individëve nuk përfshihen më në terrorizëm, ose të paktën në një shkallë shumë më të vogël, sugjeron se deradikalizimi nuk është detyrimisht kusht paraprak për riintegrimin. Hetimet e afërta të shembujve historikë të riintegritit të terroristëve mund të ofrojnë rrugë të frytshme për përmirësimin e përpjekjeve aktuale për të minimizuar normat e recidivizmit.

Një alternativë ndaj përjasjes së riintegritit me fokus te deradikalizimi, mund të gjendet në konceptin e shkëputjes. Shkëputja mund të shihet si “procesi ku një individ përjeton një ndryshim në rolin ose funksionin që zakonisht shoqërohet me një reduktim në pjesëmarrjen e dhunshme”. Kjo mund të mos përfshijë detyrimisht largimin nga lëvizja, por shoqërohet më së shpeshti me



ndryshim të konsiderueshëm të përkohshëm ose të përhershëm të roleve”.^{xxxiv} Me fjalë të tjera, ndërkohë që deradikalizimi fokusohet te ndryshimi i bindjeve të dikujt, shkëputja thekson ndryshimin e sjelljes. Terroristët ose ekstremistët e shkëputur mund të riintegrohen me sukses edhe nëse i ruajnë bindjet e tyre radikale, me kusht që të mos përfshihen më në përdorimin e dhunës terroriste në asnjë lloj mënyre.

Si me deradikalizimin, puna me shkëputjen kërkon të kuptohet se si dhe pse dikush u përfshi pikësëpari në ekstremizëm ose terrorizëm. Motivet për t’u bashkuar me këto grupe janë të shumëllojshme dhe shkojnë përtej pranimin të një ideologjie të caktuar.^{xxxv} Prandaj, programet e riintegritit duhet të jenë fleksible dhe të përshtatura me prejardhjen specifike dhe motivet e individit.^{xxxvi} E aplikuar në çështjen specifike të luftëtarëve të huaj të kthyer, kjo do të thotë të merret parasysh se ndërsa disa do të jenë ekstremistë të dedikuar dhe të kalitur në beteja, të tjerë mund të jenë përfshirë ose motivuar (fillimisht) nga mendime jo të dhunshme, si p.sh. dëshira për të ofruar ndihmë humanitare. Veçanërisht vlejné për t’u përmendur në këtë aspekt fëmijët e vegjël që janë çuar në Irak dhe Siri nga prindërit e tyre ose foshnjat që u kanë lindur luftëtarëve të huaj në ato shtete. Këta fëmijë, që mund t’i jenë nënshtruar indoktrinimit të ISIS-it që specifikisht ka pasur si synim t’i kthejë ata në ushtarë fëmijë, kërkojnë kujdes specifik, pjesërisht për të trajtuar traumën e tyre psikologjike dhe pjesërisht për të trajtuar depërtimin e mundshëm të ideologjisë ekstremiste.^{xxxvii}

Si përfundim, mungesa e vlerësimeve dhe e programeve të riintegritit dhe numri i vogël i të dhënave mbi normat e recidivizmit terrorist, pengojné seriozisht kuptimin tonë se si dhe në cilat rrethana mund të funksionojné këto programe dhe si mund të përmirësohet efektshmëria e tyre. Ndërkohë që këto mangësi duhet të adresohen urgjentisht, shqyrtimi i supozimeve të këtyre programeve rreth suksesit dhe mënyra se si arrihet ai, ofron udhëzime se si të hartohen dhe implementohen këto nisma. Në vend që të zgjidhet ose deradikalizimi ose shkëputja, informacionet aktuale sugjerojnë aplikimin e të dyja përqasjeve. Kjo ka gjithashtu përfitimin e sigurimit se programet e riintegritit kanë një masë fleksibiliteti në trajtimin e klientëve të tyre, që është një kërkesë paraprake për arritjen e reduktimit të recidivizmit, duke pasur parasysh diversitetin e motiveve dhe prejardhjeve mes atyre që përfshihen në ekstremizëm dhe terrorizëm.

Programet e riintegritit në BE

Janë duke u zhvilluar tashmë programe të shumta riintegriti në shtetet anëtare të BE-së, me nisma të reja që aplikohen çdo ditë.^{xxxviii} Shumica e nismave përfshijnë një gamë aktivitetesh si këshillim fetar, këshillim psikologjik, trajnim për aftësi profesionale, arsim dhe aktivitete argëtues. Në përgjithësi, programet që fokusohen më së shumti te ndërhyrjet fetare dhe psikologjike mund të shihen si me orientim deradikalizues. Programet që synojné në influencimin e sjelljes së dhunshme të ekstremistëve, mund të kualifikohen më shumë si me orientim shkëputës dhe shpesh mbështeten shumë në një kombinim të trajnimit arsimor dhe për aftësi në punë.



Brenda BE-së, shumica e programeve që synohen për riintegrimin e ekstremistëve të dhunshëm, mund të gjenden në Evropën Veriperëndimore të silla si programet EXIT të aplikuara në Norvegji, Suedi dhe Gjermani, si edhe “Përçasja e Aarhusit” daneze dhe nisma holandeze e riintegritit e drejtuar aktualisht nga Shërbimi Holandez i Provës. Në Gjermani, një numër organizatash janë ngarkuar me detyrën e mundësimin të rehabilitimit dhe riintegritit të ekstremistëve të dhunshëm dhe këto organizata kanë filozofinë e vet në lidhje me deradikalizimin ose shkëputjen. Më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër e programeve në Danimarkë, Gjermani dhe Holandë, për të dhënë disa informacione rreth përfitimeve dhe meritave të këtyre nismave të ndryshme.

Programi Aarhus i Danimarkës

Modeli danez i ashtuquajtur Aarhus synon të rehabilitojë luftëtarët e kthyer nga ISIS-is dhe t’i riintegrojë ata në shoqëri. Modeli Aarhus përfshin si programet parandalues ashtu edhe ato të daljes. Programi i daljes synohet për individët e radikalizuar që kanë qëllimin dhe aftësitë të kryejnë krime dhe akte terroriste me motivim politik dhe/ose fetar. Programi është përpjekje e përbashkët e policisë së Jutlandit Lindor dhe shërbimeve sociale të komunës së Aarhusit për të riintegruar me efektshmëri ekstremistët e kthyer duke (ri)krijuar besimin me autoritetet dhe duke krijuar linja të hapura komunikimi mes të kthyerve dhe qeverisë lokale. Programi ofron trajtim duke përfshirë kujdes mjekësor dhe këshillim psikologjik për trajtimin e Çrregullimit të Stresit Post-Traumatik (PTSD) dhe mentorim, si edhe mbështetje të familjeve dhe asistentë për ekstremistët e dhunshëm që aplikojnë për punë ose që i rikthehen arsimit.^{xxxix}

Pasi identifikohen individët që mund të jenë të radikalizuar, autoritetet lokale (së bashku me një klerik mysliman) u afrohen këtyre individëve në përpjekje për t’i larguar nga radikalizimi dhe ekstremizmi. Ekziston gjithashtu një Infohouse që filtron telefonatat dhe përcakton prioritetet e ndërhyrjeve. Pjesa më e madhe e punës bëhet përmes kuadrit SSP mbi parandalimin e krimit – dialogu mes Shkollave, Shërbimeve sociale dhe Policisë. Komisioneri i policisë i qytetit ka deklaruar se kjo përpjekje parandaluese dhe dialogu që ka ndihmuar të krijohet brenda komunitetit mysliman, ka ndihmuar në uljen e numrit të luftëtarëve të huaj që nisen nga Aarhusi nga tridhjetë në vitin 2013 në një në vitin 2014.^{xi} Megjithatë, disa parti duke përfshirë edhe Partinë e Popullit Danez që është kundër emigrimit, kanë shprehur shqetësime në lidhje me programin, duke argumentuar se kjo përpjekje është “tepër e butë, naive dhe dritëshkurtër”.^{xli} Aktualisht, efektshmëria afatgjatë është ende çështje debati dhe është tepër herët për të nxjerrë konkluzione.

Rrjeti i Parandalimit të Dhunës në Gjermani

Në Gjermani, një numër organizatash po kryejnë përpjekje rehabilituese për ekstremistët e dhunshëm. Një prej këtyre organizatave, Rrjeti i Parandalimit të Dhunës, është një OJQ që punon me të rinjtë që janë të ekspozuar ndaj ekstremizmit të djathtë të dhunshëm ose fundamentalizmit fetar të dhunshëm. Programi kryhet në bazë vullnetare dhe individët që regjistrohen takohen në grupe të vogla të cilët takohen një herë në javë gjatë një periudhe 23-javore. Përçasja e programit synon kryesisht deradikalizimin dhe kombinon modulet e edukimit civil dhe trajnimit pedagogjik me trajnimin kundër dhunës. Fokusi te deradikalizimi nënkupton një përpjekje për të “veçuar sensin e



zemërimit dhe urrejtjes së individit nga pikëpamja e tij politike për botën dhe për ta ndihmuar në trajtimin e faktorëve që nxisin zemërimin e tij si edhe për t’i riedukuar ata sipas sjelljeve të shoqërisë demokratike dhe mënyra alternative për të shprehur dhe për t’iu përgjigjur shqetësimeve të tyre”.^{xlii} Trajnimi fillon brenda pesë muajve nga burgosja dhe vazhdon përmes trajnimit deri në lirim. Organizata ofron gjithashtu këshillim për prindërit fëmijët e të cilëve janë bashkuar ose janë në rrezik të bashkohen me një organizatë terroriste.

Megjithëse programi kryesisht synon të nxisë deradikalizimin, ai përfshin edhe elemente të shkëputjes. Mentori që është caktuar për një individ, e ndihmon atë të gjejë akomodim dhe punë, si dhe mundëson një numër takimesh me anëtarët e familjes. Sipas një vlerësimi të brendshëm të projektit, mund konsiderohet si program i suksesshëm (norma e recidivizmit të pjesëmarrësve që kanë përfunduar programin është vetëm 5% dhe norma e largimit nga programi është 2%).^{xliii} Megjithatë, organizata nuk i zbulon statistikën në lidhje me numrin total të pjesëmarrësve dhe të “të diplomuarve” nga programi, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e këtyre përqindjeve në kontekstin përkatës.

Përfaqja ndaj riintegrit në Holandë

Në vitin 2012, në Holandë u prezantua një projekt specifik riintegrimi që fokusohet te personat në lirim me kusht ose në shërbim prove që (dyshohet se) ishin përfshirë në terrorizëm ose ekstremizëm “xhihadist”.^{xliii} Koordinatori Kombëtar Holandez për Sigurinë dhe Kundërterrorizmin (NCTV) e themeluan këtë projekt së bashku me Shërbimin Holandez të Provës për të përmirësuar riintegrimin e atyre që kanë kryer vepra ekstremiste në Holandë. Objektivi kryesor i përfaqesjes është reduktimi i mundësisë së recidivizmit mes atyre që kanë kryer vepra ekstremiste dhe terroriste përmes risocializimit dhe masave të kujdesit vijues. Duke asistuar të ashtuquajturit klientë të programit në gjetjen e një pune, shkollimit, strehimit dhe shlyerjes së borxheve dhe duke iu adresuar problemeve psikologjike ose pajtimit me anëtarët e familjes, janë komponentët e rëndësishëm të kësaj përfaqesjeje.

Njëkohësisht, klientët monitorohen për të parandaluar një kthim në rrethet ekstremiste. Kur personeli i programit e gjykon se përgjegjësitë e tyre kanë reaguar ndaj këtyre përpjekjeve, prezantohet një komponent deradikalizues që mbështetet pjesërisht në konsulentë të jashtëm me njohuri teologjike për të kryer ndërhyrje njohëse. Këto synojnë të injektojnë zona “gri” te këta klientë që shpesh kanë botëkuptime shumë bardhezi. Në fund, shpresohet që këto përpjekje deradikalizimi do të sjellin heqjen dorë nga mbështetja për dhunë. Në lidhje me normën e suksesit të këtij programi, Schuurman & Bakker (2015) shprehen se nuk mund të nxirren ende konkluzione afatgjata sepse projekti ishte ende në fazat e tij të hershme kur ata kryen vlerësimin.^{xliii}



Reagimi

Ndërkohë që shumë shtete të BE-së kanë implementuar programe riintegrimi të fokusuara ose te deradikalizimi, ose te shkëputja, ose te të dyja, ato variojnë shumë në përmasjet e aplikuar. Ekzistojnë ndryshime në lidhje me objektivin e programeve (p.sh. luftëtarët e huaj të kthyer, ata që kanë kryer vepra ekstremiste të dhunshme, individët vulnerabël ndaj radikalizimit ose të gjitha sa më lart); në cilën fazë implementohen programet (para burgut, gjatë burgut, pas burgut); në çfarë baze marrin pjesë individët në program (me dëshirë apo me detyrim); kush është përgjegjës për implementimin e programit; dhe elementet e programit që janë përfshirë në program (p.sh. këshillimi psikologjik, edukimi, këshillimi fetar etj.).

Për shkak të pasigurive aktuale nëse këto përpjekje janë të efektshme në uljen e recidivizmit të lidhur me terrorizmin, nuk mund të nënvizohen ende në mënyrë përfundimtare meritat dhe mangësitë specifike të këtyre nismave. Është ende e mundshme që të ofrohet udhëzim praktik për ata që hartojnë ose implementojnë programe të ngjashme. Ky seksion ofron një përmbledhje koncize të sugjerimeve për të përmirësuar përpjekjet ekzistuese për riintegrim dhe për t'iu adresuar çështjeve të theksuara në faqet e mëparshme. Duke parë numrin e të kthyerve dhe trysninë e madhe të mundshme në nismat ekzistuese të riintegrimit, trajtimit të këtyre çështjeve duhet t'i jepet prioritet në nivelet e qeverisjes lokale, kombëtare dhe të BE-së.^{xlvi}

1. Dhënia përparësi vlerësimit të programeve të riintegrimit

Programet e riintegrimit, si ato të reja dhe ato ekzistuese, duhet t'i nënshtrohen vlerësimit kritik, të pavarur dhe në kohë reale në mënyrë që të mund të vlerësohen objektivat, supozimet e tyre rreth mënyrës së arritjes së tyre, implementimi organizativ dhe shkalla e suksesit.^{xlvii} Kjo është thelbësore në hartimin dhe implementimin e nismave më të efektshme dhe kështu duke minimizuar mundësinë e recidivizmit terrorist.

2. Grumbullimi i të dhënave rreth recidivizmit terrorist në BE

Ky informacion kritik do të mundësojë një kuptim të shkallës së problemit dhe ofron një standard matjeje të përafërt për identifikimin e programeve të efektshmërisë mbi dhe nën mesataren, që nga ana e vet mund të përdoret për të izoluar praktikatat më të mira dhe më të këqija. Të dhënat rreth recidivizmit terrorist do të lejojnë gjithashtu që sukcesi i programeve të riintegrimit të matet në një sens krahasues. Kjo ofron një standard më objektiv për matjen e suksesit të tyre.

3. Garantimi se përpjekjet e riintegrimit janë fleksible dhe të përshtatura

Luftëtarët e huaj të kthyer nuk janë një grup homogjen. Për të qenë të efektshme, programet e riintegrimit duhet të jenë fleksible dhe të përshtatura sipas karakteristikave dhe nevojave specifike të individit. Çdo përpjekje për të riintegruar ekstremistët ose terroristët duhet të fillojë me një vlerësim të nevojave, narrativave dhe rrjeteve të individit, duke përdorur metodat specifike të vlerësimit të rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm. Aktualisht, në mbarë botën po përdoren mjete të ndryshme të vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë Modeli i Prioriteteve të të Dytshuarve



Terroristë të Kthyer (Returning Terrorist Suspect (RTS) Prioritization Model - Australi); Kuadri i Vlerësimit Dinamik (Dynamisch Beoordelingskader - Holandë); Udhëzuesi i Rrezikut të Ekstremizmit 22+ (Extremism Risk Guidance 22+ (ERG22+) - Mbretëria e Bashkuar); Vlerësimi i Rrezikut të Ekstremizmit të Dhunshëm (Violent Extremist Risk Assessment (VERA) - Kanada) dhe Testi i Vlerësimit të Kërkimit të Domethënies (SQAT) - SHBA).

Të gjitha këto mjete kanë të përbashkët një numër treguesish me anë të të cilëve do të gjyko-
het niveli i ekstremizmit të një personi. Megjithatë, metodologjia përkatëse varion nga gjykimi
i strukturuar profesional (ERG 22+, VERA, Dynamic Assessment Framework) deri te pyetësorët
vetjakë (SQAT). Për t'u përdorur me efektshmëri, çdo mjet duhet të përshtatet me rrethanat lo-
kale dhe personeli duhet të trajnohet për të aplikuar metodologjinë në mënyrë të përshtatshme.
Pavarësisht pikave pro dhe kundër të mjeteve specifike të vlerësimit, është thelbësore një analizë
e strukturuar e programit të riintegrit për të marrë parasysh historitë e jetës së pjesëmarrësve,
aftësitë njohëse dhe matjet e tjera të ndryshme për të mundësuar hartimin dhe implementimin e
përqasjeve të personalizuara.

4. Ndjekja si e deradikalizimit ashtu edhe e shkëputjes

Duke pasur parasysh pasigurinë rreth asaj që funksionon më mirë kur bëhet fjalë për riintegri-
min e ekstremistëve dhe terroristëve, programet nuk duhet të mbështeten në një përqasje të
vetme. Deradikalizimi, që thekson largimin e klientëve nga bindjet e tyre ideologjike, sigurisht që
ka vendin e vet në këto përpjekje, por duhet të shihet si një mes shumë rrugëve të mundshme
përmes të cilave të minimizohen shanset e recidivizmit në terrorizëm. Shkëputja thekson më shu-
më ndryshimin e sjelljes sesa atë ideologjik dhe përfshin arsyet e ndryshme për përfshirjen dhe
distancimin nga terrorizmi, duke ofruar një shumëllojshmëri rrugësh përmes të cilave të punohet
drejt riintegrit. Siç tregojnë tre shembujt nga Danimarka, Gjermania dhe Holanda, në vend që
të shihen si alternativa që përjashtojnë njëra-tjetrën, programet e riintegrit duhet të përfshijnë
si përpjekjet e deradikalizimit ashtu edhe ato që fokusohen te shkëputja.

5. Përfshirja e menjëhershme me luftëtarët e huaj të kthyer

Për shkak të kërcënimit të mundshëm që paraqitet nga luftëtarët e huaj të kthyer dhe, si alterna-
tivë, nevojës për të ndihmuar ata që mund të shihen si viktima të rekrutimit të ISIS-it, duhet të
eksplorojnë mundësitë për pjesëmarrje të menjëhershme në programet e integrit. Duhet të
krijohen dhe të bëhen publike mundësitë për pjesëmarrje vullnetare, ndoshta si pjesë e një fusha-
te kundër narrativave ekstremiste.^{xlviii} Duhet konsideruar përdorimi i ish-ekstremistëve, që janë
distancuar nga ISIS-i dhe grupe të ngjashme, për të joshur të tjerët që të ndjekin gjurmët e tyre.^{xlix}
Megjithatë, duhet të ushtrohet kujdes për të matur sinqeritetin e tyre.ⁱ

Në të njëjtën kohë, edhe për ata (me shumë gjasa, shumica e tyre) të kthyer që nuk përfshihen
me dëshirë në programet e riintegrit. Kjo nuk është domosdoshmërisht një pengesë e pakapër-
cueshme; terroristë janë shkëputur edhe gjatë burgosjes (p.sh. pa dëshirë). Gjithashtu, studimet
kanë treguar se individët që bëhen pjesë e trajtimit kundër abuzimit me drogat qoftë me dëshirë
apo jo, shpesh kanë rezultate të ngjashme.ⁱⁱ Teorikisht, të paktën, ka kështu arsye për të ndjekur



pjesëmarrjen pa dëshirë në nismat e riintegritimit.^{lii} Por çfarë rrugësh ligjore ekzistojnë për zbatimin e pjesëmarrjes në këto programe?

6. Mësoni nga historiku më i fundit

Duhet t'i jepet prioritet vlerësimit të programeve aktuale të riintegritimit. Megjithatë, historiku më i fundit ofron një shumëllojshmëri shembujsh të terroristëve evropianë që janë kthyer në shoqëri pas burgimit. Përvojat e shteteve si Spanja, Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Italia dhe Gjermania mund të ofrojnë shumë informacione të dobishme që nuk janë shfrytëzuar pothuajse aspak.

7. Integrimi i praktikave më të mira në programet e riintegritimit

Pavarësisht mungesës së studimeve vlerësuese, ato studime që janë kryer, si edhe programet aktuale të riintegritimit, ofrojnë informacione të përgjithshme për përdorim të menjëhershëm praktik. Këto përfshijnë:

- Rëndësinë e një marrëdhënieje besimi mes personelit të programit dhe klientëve, duke përfshirë punonjësit e programit që i marrin seriozisht individët dhe idetë e tyre;
- Çdo program riintegritimi duhet të shprehë qartë objektivat e programit si edhe treguesit e suksesit ose të dështimit;
- Programet kanë mundësinë më të lartë të suksesit kur bazohen te respekti për të drejtat e njeriut;
- Personeli i trajnuar mirë është me rëndësi të lartë - personeli duhet të ketë një kuptim të plotë të objektivave të programit dhe një qëndrim pozitiv, të qëndrueshëm dhe të drejtë;
- Programet kanë nevojë për fleksibilitet operacional për t'iu përshtatur rrethanave të paparashikuara;^{liiii})
- Nuk ka zgjidhje që përshtatet për çdo skenar, çdo përpjekje për riintegrim duhet të bazohet në një procedurë të shëndoshë marrjeje dhe vlerësimi rreziku për të përcaktuar nevojat e individit, shkallën e besnikërisë ndaj narrativës ekstremiste, rrethin shoqëror dhe aftësitë;^{liv}
- Bashkëpunimi i efektshëm mes agjencive dhe organizatave të ndryshme të përfshira në përpjekjet e riintegritimit (p.sh. shërbimi i provës, policia, qeverisja vendore, prokuroria publike) është me rëndësi të madhe;^{lv}
- Natyra kontroverse e programeve të riintegritimit për (ish) ekstremistët dhe terroristët, kërkon menaxhim të efektshëm të pasojave negative të mundshme politike dhe sociale, veçanërisht ato që lindin nga rastet e pashmangshme të recidivizmit.^{lvi}



Konkluzioni

Riintegrimi i (ish) ekstremistëve dhe terroristëve në shoqëri do të jetë gjithmonë një sipërmarrje e vështirë dhe kontroverse. Ka të ngjarë të ketë kritika të forta për këtë përqasje dhe disa mund ta kritikojnë si “të butë” ndaj terrorizmit. Me numrin e luftëtarëve të huaj të kthyer që pritet të rritet, dhe me radikalizimin “e lindur brenda vendit” paralelisht të islamistëve dhe grupet e djathta, nuk mund të shmanget çështja se çfarë duhet të bëhet me ekstremistët dhe terroristët e liruar nga burgu ose të kthyer nga konfliktet jashtë vendit.

Duke parë rritjen e kërkesës për kapacitetin e riintegrimit, duhet të adresohen me urgjencë problemet dhe boshllëqet në njohuritë aktuale, të theksuara në këtë Raport. Radicalisation Awareness Network (RAN) është në një pozicion të shkëlqyer për t’i sjellë këto çështje në vëmendje të politikëbërësve, specialistëve dhe akademikëve. Shpresohet që në të ardhmen e afërt të shohim zbatimin e projekteve të studimit në bashkëpunim të ngushtë me politikëbërësit dhe ekspertët specialistë, që do të mundësojnë që riintegrimi i terroristëve dhe ekstremistëve të kryhet me konfidencë më të lartë dhe me një mundësi më të lartë për të arritur një reduktim aktual dhe të matshëm të rrezikut të recidivizmit.



Referim

1. 24, France. "France Unveils First De- Radicalisation Centre to Tackle Islamist Threat." *France 24*, 14 September 2016.
2. Abrahms, Max. "What Terrorists Really Want: Terrorist Motives and Counterterrorism Strategy." *International Security* 32, no. 4 (Spring 2008): 78-105.
3. Alonso, Rogelio, and Javier DíazBada. "What Role Have Former Eta Terrorists Played in Counterterrorism and Counterradicalization Initiatives in Spain?" *Studies in Conflict & Terrorism* 39, no. 11 (2016): 982-1006.
4. Bandura, Albert. "Mechanisms of Moral Disengagement in Terrorism." In *Origins of Terrorism: Psychologies, Ideologies, Theologies, States of Mind*, edited by Walter Reich, 161-91. Cambridge: Cambridge University Press, 1990.
5. Barrett, Richard, and Laila Bokhari. "Deradicalization and Rehabilitation Programmes Targeting Religious Terrorists and Extremists in the Muslim World: An Overview." In *Leaving Terrorism Behind: Individual and Collective Disengagement*, edited by John Horgan and Tore Bjørgo, 170-80. London / New York: Routledge, 2009.
6. Bjørgo, Tore. "Exit Neo-Nazism: Reducing Recruitment and Promoting Disengagement from Racist-Groups." In *NUPI Working Paper*. Oslo: Norsk Utenriks politisk Institutt, 2002.
7. Braddock, Kurt, and John Horgan. "Towards a Guide for Constructing and Disseminating Counternarratives to Reduce Support for Terrorism." *Studies in Conflict & Terrorism* 39, no. 5 (2016): 381-404.
8. Bruyning, Simon. "Rechter: Wet Is Niet Berekend Op Syriëgangers." *Trouw*, 9 February 2015.
9. Byman, Daniel. "The Homecomings: What Happens When Arab Foreign Fighters in Iraq and Syria Return?" *Studies in Conflict & Terrorism* 38, no. 8 (2015): 581-602.
